

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Driton Muharremi e Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Shaqë Curri, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.H. nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit M.H., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.57/14 datë 31.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur në pajtim me dispozitën e nenit 390 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), më 13.06.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.H., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, P.nr.57/16 datë 31.10.2016, vetëm përkitazi me vendimin për dënim dhe për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës të akuzuarit M.H. për këtë vepër penale për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej 28.08.2013 deri me 13.10.2013 dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktgjykimin P.nr.57/14 datë 31.10.2016, të akuzuarin M.H., e ka shpallur fajtor për veprat penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK, veprës penale Mbajtja në pronësi, kontrollë ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK dhe veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK, për çka për veprën penale të parë e ka gjykuar me dënim burgu prej 9 (nëntë) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, për veprën e dytë penale dënimi me gjobë prej 500 eurove ndërsa për veprën e tretë penale dënimi me gjobë në shumë prej 800 (tetqindë) eurove ashtu që konform nenit 80 të KPRK i ka shqiptuar dënim unik me burg

në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj në të cilin dënim ia ka llogarit edhe kohën e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 28.08.2013 deri me datën 13.10.2013 dhe dënim me gjobë në shumë prej 2300 eurove të cilat obligohet ti paguaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I ka shqiptuar dënimin plotësues – konfiskimi i armës-pistoletës me numër serik M-57, kalibër 7.62mm me numër serik E-57622, një karikator dhe 6 fishek të kalibrit 7.62mm. Për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike i dëmtuari udhëzohet në kontest civil. Është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 euro si dhe 20 euro në emër të paushallit gjyqësor.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të akuzuarit M.H. av. M.H., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit, ta ndryshon aktgjykimin e shkallës së parë dhe të akuzuarit të i shqiptoj dënim nën 6 muaj burgim dhe t'ia shëndrroj me dënim me të holla dhe dënim unik sa më të butë.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Nuk prezantoi prokurori i Apelit, ndërsa prezent ishin i akuzuari M.H. dhe mbrojtësi av. M.H.. Mbrojtësi mbeti pranë pretendimeve ankimore të bëra me shkrim ndërsa i akuzuari mbështeti mbrojtësin e tij.

Prokuroria e Apelit me propozimin e dhënë me shkrim PPA/I.nr. 611/16 datë 25.11.2016 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa është e bazuar vetëm përkitazi me vendimin mbi dënim.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke analizuar ankesën e mbrojtësit dhe shkresat e lëndës shihet se pas marrjës së aktgjykimit nga ana e gjykatës së shkallës së parë mbrojtësi i të akuzuarit av. M.H. është ankuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës e cila me aktgjykimin PAKR.nr.652/16 të dt. 06.02.2017 ka refuzuar ankesën e mbrojtësit ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Ndaj këtij aktgjykimi mbrojtja ka ushtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës e cila gjykatë me aktgjykimin e sajë PML.nr.58/17 të dt. 27.04.2017 ka miratuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit M.H. duke anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit vetëm në raport me veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 par.2 të KPRK dhe këtë

çështje në këtë pjesë e ka kthyer në rivendosje. Ndërsa për veprat penale nga neni 374 par.1 të KPRK dhe veprës penale nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK dhe dënimet me gjobë të shqiptuara për këto vepra penale në shumë të përgjithshme prej 1300 eurove, në këtë drejtim aktgjykimi i kundërshtuar ngel i pa prekur.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit M.H. lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa është e bazuar kjo për faktin se siç rezulton nga shkresat e lëndës të kësaj çështjeje penalo-juridike por edhe nga marrëveshja për pranimin e fajësisë në mes të palëve, gjykata e shkallës së parë sa i përket veprës penale nën pikën I gjegjësisht veprës penale nga neni 374 par.1 të KPRK ka tejkaluar limitet e dënimit të rekomanduar nga Prokurori i Shtetit e që siç shihet palët janë pajtuar që ky dënim të jetë 6 muaj, prandaj kjo gjykatë e aprovoi ankesën e mbrojtësit dhe të akuzuarit M.H. i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, dënim ky i paraparë siç u cekë më lartë me marrëveshjen për pranimin e fajësisë. Ndërsa sa i përket pretendimit të mbrojtësit që dënimi të jetë nën 6 muaj burgim dhe i njëjti të shndërrohet me gjobë, një kërkesë e tillë është e pa bazuar për faktin se Marrëveshja për pranimin e fajësisë është bërë me vullnetin e të dy palëve dhe me prezencën e mbrojtësit të akuzuarit, ashtu që një mundësi e tillë siç propozohet nga ana e mbrojtësit nuk është paraparë me këtë marrëveshje.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.281/2017, më 13.06.2017

Procesmbajtësja,
Shaqë Curri _____

Kryetarja e kolegjit- gjyqtari
1.Mejreme Memaj _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi _____

3. Fillim Skoro _____